



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of
Communities and Return*

Data: 26.10.2018-09.11.2018

Ministria për Komunitete dhe Kthim duke u bazuar ne Ligjin mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 , si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në : Departamentin për Planifikim të Politikave dhe Analiza - Divizioni për Planifikim të Politikave në MKK

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i lartë për planifikim të politikave (1 vend pune)

Numri i referencës së vendit të punës: MKK-DPPA - 03/2018

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës : 8

Koeficienti : 8

Kategoria e punësimit : e karrierës

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës

Përgjegjësitë mbikëqyrëse : Jo

Raporton te : Udhëheqësi i Divizionit për planifikim të politikave

Orari i punës : I plotë

Vendi i punës : Fushë Kosovë

Qëllimi i vendit të punës: Brenda një fushe të caktuar të ekspertizës profesionale dhe nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Planifikim të Politikave, kryen detyra të rëndësishme profesionale dhe ofrimin e shërbimeve dhe produkteve në nivel profesional që kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve të njësisë organizative dhe këshillon stafin e nivelit më të ulët dhe grupet punuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Planifikimi i aktiviteteve për planet e punës dhe afatet kohore, në koordinim me mbikëqyrësit, për zbatimin e projekteve dhe shërbimeve që lidhen me fusha specifike profesionale;
2. Kryen detyrat e përcaktuara në planet e miratuara të punës në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afatit të specifikuar kohor;
3. Është përgjegjës për monitorimin e projekteve përfituese të subvencionuara për regionin përkatës, vlerëson saktësin e raporteve të përfituesve si dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për përfituesit e subvencionuar.;
4. Menaxhon grupet e punës në fusha përkatëse kur kërkohet;
5. Ofron këshilla për personelin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
6. Ofron mbështetje në menaxhimin e bazës qendrore të të dhënave në lidhje me procesin e integritit të komuniteteve, gjithashtu është pjesë e ekipit të përditësimit dhe koordinimit të bazës së të dhënave;
7. Koordinon punën me njësitë e tjera të institucionit dhe komunikon sipas nevojës me institucionet relevante si dhe përcjellë zbatimin e ligjit për promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;
8. Për punën dhe aktiviteteve të tij/ saj i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Divizionit për Planifikim të Politikave;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :

- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale,

Shkollimi i kërkuar :

- Diplomë universitare – Fakulteti juridik, ekonomik, shkencat politike, administratë publike apo ndonjë drejtim i përafërt.

Shkathtësitë e kërkuara :

- - Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën përkatëse;
- - Njohja e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- - Aftësitë e komunikimit, planifikimi i punës;
- - Aftësi kërkimore, analitike, vlerësimi dhe formulimi i rekomandimeve dhe këshillave të ekspertëve;
- - Të jetë në gjendje të punojë nën presion, të ketë etikë të lartë për punë dhe të punojë me orar fleksibil të punës ;
- - Nohja e gjuhëve zyrtare Shqipe dhe Serbe si dhe njohja e gjuhës angleze do të jetë përparësi
- - Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Procedurat e Konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues.

Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MKK-së dhe shtypin ditor .

Paraqitja e kërkesave:

Formularët për aplikim mund të merren çdo ditë pune nga ora 09:00 deri ora 15:30, zyra nr.12 në lokalet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Fushë Kosovë (ndërtesa e Hekurudhës, pranë ndërtesës së Stacionit Policor të Trafikut Regjional të Prishtinës) ose të tërhiqen nga ueb faqja e MKK-së ku është bërë edhe shpallja e rekrutimit në adresën : www.mkk-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Burime Njerëzore të MKK-së nr.12 ose nëpërmjet të postës në adresën : Ish ndërtesa e Hekurudhës ,Sheshi Nëna Terezë , Fushë-Kosovë.

Për informata më të hollësishme kontaktoni në nr. e tel.038/200 16-544, 200 16-543, 200 16-537, 200 16-531

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet në vijim :

- 1. Certifikata e lindjes.**
- 2. Diploma e përgatitjes shkollore.**
- 3. Fotokopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.**
- 4. Dëshmia mbi përvojën e punës.**
- 5. Rekomandimet dhe dokumentet shtesë nëse i posedon.**
- 6. Vërtetimi nga Gjykata që nuk është nën hetime .**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".